12/02/2021

“Shën Mëria në fron me Krishtin, Zonja e Engjëjve”, ikona e pikturuar rreth viteve 1650



Ikona “Shën Mëria në fron me Krishtin, Zonja e Engjëjve” është pikturuar rreth viteve 1650 dhe vjen nga zona e Kolonjës.

Muzeu i Artit Mesjetar bën të ditur se në sfondin e artë predominon figura e Shën Mërisë e ulur në fron duke mbajtur Krishtin fëmijë në prehër.

Në pjesën e sipërme paraqiten dy kryeengjëjt me krahë të hapura dhe me duart në pozicion lutjeje.

Ky lloj kompozimi ku Shën Mëria e ulur në fron druri shumë të dekoruar me harqe të gdhendura dhe dantella u shfaq kryesisht gjatë shekullit XVIII në shkollën e Kretës, Tebës dhe në ishuj.

Draperitë në maforin e Virgjëreshës si dhe këpucët e kuqe të kujtojnë pikturat e

piktorit kretian Theofan të pikturuara në kishën e Shën Nikollës në Meteora.



— ata.gov.al